Republika e Kosovës
Republika Kosova - Repubic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

09 -09- 2019

Prishtinë / Pristina

Nr. / Br. 974 - 2019

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Komisioni Qendror i Zgjedhjeve***
***Centralna Izborna Komisija***
***Central Election Commission***

Në pajtim me autorizimet e dhëna nga neni 63.4, neni 15.5 nenit 25 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 6.3 dhe nenit 7.1 të Rregullës Zgjedhore nr.08/2013 Çertifikimi i Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të Tyre dhe nenit 3 të Rregullës Zgjedhore 15/2013 Zgjedhjet e Parakohshme, **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** me datë 10/09/2019 merr këtë:

# V E N D I M

I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për çertifikimin e Partisë Politike "LËVIZJA VETËVENDOSJE", për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, me njëqind e dhjetë (110) kandidatë në Listë.

II. Zyra obligohet që të njoftoj Partinë Politike "LËVIZJA VETËVENDOSJE", për marrjen e këtij Vendimi, pasi janë plotësuar kriteret e përcaktuara për certifikim për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06 Tetor 2019.

III. Subjekti politik i çertifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së një njoftim me shkrim në të cilin shpreh qartazi qëllimin për tërheqje, jo më vonë se nje (1) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit për zgjedhje.

IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit

Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka

**Këshillë juridike:** Brenda 24 orëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, të gjithë personat që kanë interes ligjor kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP.